

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Mustafa kryetare, Valdete Daka dhe Nesrin Lushta, anëtare, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini-Simnica, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit Sh.B., nga Gjakova, për shkak të veprës penale ndryshimi i njehsorit të shërbimeve nga neni 323 par.2 lidhur me par.1 të KPK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit avokati T.B., ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë P.nr.33/2014 datë 08.09.2016, dhe kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.1375/2016 datë 17.01.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 23.01.2018, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit Sh.B., anulohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë P.nr.33/2014 datë 08.09.2016, dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.1375/2016 datë 17.01.2017, ndërsa çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjakovë me aktgjykimin P.nr.33/2014 datë 08.09.2016, të dënuarin Sh.B. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale ndryshimi i njehsorit të shërbimeve nga neni 323 par.2 lidhur me par.1 të KPK, dhe për këtë vepër e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 500 €, të cilën gjobë i dënuari është i obliguar ta paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjyqimit si dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari në afat prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale. Nëse i dënuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgu ashtu që për çdo 20 € të gjobës do t'i llogaritet një ditë burgu. Është obliguar që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 30 €, ndërsa të dëmtuarën KEDS- distrikti në Gjakovë për realizmin e kërkesës pasurore juridike e ka udhëzuar në kontest juridiko- civil.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit të Kosovës me aktgjykimin PA1.nr.1375/2016 datë 17.01.2017, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjytimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të dënuarit Sh.B. avokati T.B., nga Gjakova, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 të KPPK, dhe shkeljes së ligjit penal nga neni 432 par.1 pika 1 të KPPK, si dhe për shkak të shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, neni 432 par.1 pika 3 e KPPK, me propozim që aktgjykimet e atakuara të anulohen dhe çështja të kthehet për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë ose të ndryshohen dhe i dënuari të lirohet nga akuza.

Prokurori i Shtetit me parashtresën KMLP.II.nr.21/2017 datë 14.02.2017, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e ushtruar nga mbrojtësi i të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në pajtim me dispozitën e nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë gjeti se:

Kërkesa e mbrojtësit për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Në kërkesë mbrojtësi pretendon se aktgjykimet e atakuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 të KPPK, duke mos cekur konkretisht pikën e dispozitës ligjore por duke theksuar se aktgjykimet e atakuara janë në kundërshtim me parimet themelore të KPPK, respektivisht me nenin 7 të KPPK, me të cilin gjykata dhe Prokurori i Shtetit janë të obliguar për vërtetimin e plotë dhe të saktë të fakteve dhe rrethanave për të cilat ngarkohet i akuzuari duke iu referuar pastaj gjendjes faktike meqë nga gjendja faktike e ekzaminuar del se orëmatësi i cili është objekt i aktakuzës ka qenë në mbikëqyrje permanente nga KEDS, dhe mund të jetë gërvishur por kjo nuk do të thotë, përkatësisht nga gjendja faktike nuk vërtetohet se i dënuari ka bërë çfarëdo ndërhyrje, kjo aq më tepër nga fakti se në shkresat e çështjes janë dy ekspertiza njëra nga eksperti gjyqësor R.H. dhe nga komisioni për kalibrim në Prishtinë e bërë në bashkëpunim me zyrtarët MTI-DMK, të cilat kanë kundërthënie dhe konstatime diametralisht të kundërta e të cilat do të ndikonin në përgjegjësinë penale të të dënuarit. Për rrjedhojë, dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk është i qartë sepse i njëjti është kundërthënës në brendinë e tij, me arsyet e aktgjykimit përkatësisht me gjendjen në shkresat e lëndës.

Gjykatat e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë pa asnjë provë e shpallin fajtor të dënuarin Sh.B., edhe pse nga shkresat e çështjes nuk ka pas prova për fajësinë e tij e që është shkelje e ligjit penal në dëm të të dënuarit.

Gjykata Supreme duke vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit si dhe nga shkresat e çështjes gjen se i dënuari është pronar i separacionit NTSH "B." dhe se i njëjti që nga viti 2011, ka shfrytëzuar rrymën nga KEDS. Me rastin e ndërrimit të

njehsorit elektrik me atë digjital komisioni përkatës nga KEDS, në procesverbalin e datës 20.06.2013, ka konstatuar se njehsori elektrik i ka bllobat shtetërore të falsifikuara dhe se numëruesi i njehsorit është i manipuluar, se ka gjurmë të gërvishjes së numrave në numëror dhe atë shifra e tretë nr.2, 4, 5 shifra 4 nr.1 në T1, dhe se njehsori i tillë është dërguar në kalibrim në Qendrën e kalibrimit në Prishtinë ku nga komisioni përkatës është vërtetuar se njehsori elektrik është jashtë kufijve të lejuar për matjen e energjisë elektrike e kjo vërtetohet nga procesverbali nr.14769 i datës 20.06.2013.

Me urdhëresë të Gjykatës Themelore në Gjakovë, është urdhëruar ekspertizë, e sipas kërkesës së mbrojtësit të të dënuarit dhe është caktuar eksperti i lëmisë elektro energjetike ing. R.H. i cili ka bërë ekspertizën, kontrollin detal të njësorit të energjisë elektrike me nr.8399965 të tipit DAG dhe i njëjti pasi që ka bërë kontrollin ka dhënë mendimin-ekspertizën se është e pamundur të vërtetohet se konsumatori Sh.B. ka bërë manipulim të njësorit të lartcekur, se KEDS nuk ka mund të sigurojë dokumentin bazë kur ka filluar konsumatori ta shfrytëzojë këtë njësor si dhe gjendjen e njehsorit në kohën e pranimit teknik, të kryer nga personeli i KEDS. Në këtë ekspertizë ka edhe disa konstatime të cilat janë në kundërshtim me raportin e kalibrimit nga qendra e kalibrimit ndërkaq, gjykata e shkallës së parë fare nuk lëshohet në shqyrtimin e këtyre ekspertizave kundërthënëse respektivisht nuk ka urdhëruar një super ekspertizë, me të cilën do të sqaroheshin qartë shkeljet eventuale nga ana e të dënuarit.

Duke u nisur nga ky fakt Gjykata Supreme, konsideron se aktgjykimet e kontestuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 12 të KPPK, sepse dispozitivi është në kundërshtim me arsyetimin e aktgjyqimeve andaj edhe i anuloi të njëjtat.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të urdhërojë një ekspertizë tjetër, nga një institucion kompetent i pavarur, të mënjanojë dyshimin se a ka ndërhyrje në njehsorin elektrik dhe pasi që të mënjanoje të njëjtin duke i administruar provat një nga një të cilat gjenden në shkresat e çështjes të vendos në mënyrë meritore.

Duke u nisur nga fakti se ndaj të dënuarit është shkelur ligji penal në dëm të të njëjtit, e duke u bazuar në nenin 438 par.1 pika 2 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
PML.nr.26/2017 datë 23.01.2018

Procesmbajtës,
Mirlinda Mejzini-Simnica

Kryetare e kolegjit,
Emine Mustafa